



**Hapet Thirrja për 2 Bursa për Stafin Administrativ
në Programin Erasmus +
në Universitetin e Edukimit Fizik, Budapest-Hungari**

Në kuadër të programit Erasmus + është hapur thirrja për aplikime për 2 bursa për mobilitete për stafin administrativ të Universitetit të Sporteve të Tiranës në Universitetin e Edukimit Fizik, Budapest-Hungari.

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Staf i administrativ për trajnim;

Kohëzgjatja e bursave:

-Shkëmbimi i stafit administrativ për trajnim (5 ditë, pa përfshirë ditët e udhëtimit);

Bursa përfshin:

-Kompensimin ditor (140 EUR në ditë për stafin);

-Kostot e udhëtimit 275 EUR.

Dokumentat e nevojshme për aplikim për stafin administrativ:

- CV (në gjuhën angleze);
- Një letër motivimi (në gjuhën angleze);
- Një letër reference (në gjuhën angleze);
- Plani i mobilitetit për trajnim (në gjuhën angleze);
- Vërtetim Punësimi (në gjuhën shqipe);
- Fotokopje e certifikatës së gjuhës së huaj që vërteton njohuritë e gjuhës angleze
- Kopje e Pasaportës.

Afati për aplikime: 27 Shkurt 2020

Për të aplikuar ju lutemi të dorëzoni dokumentat dorazi pranë Zyrës së Protokollit në Rektoratin e Universitetit të Sporteve të Tiranës, dhe të dërgohen njëkohësisht të skanuara në adresën contact@ust.edu.al.

Për më shumë informacion mund të na kontaktoni në Rektoratin e Universitetit të Sporteve të Tiranës, Drejtoria e Koordinimit, Marrëdhëniet me Jashtë, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni në adresën: contact@ust.edu.al.

Universiteti i Sporteve të Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!